



Maj 2022

Regjistrohuni tani në Forumin e Ujit të Danubit 2022!



SHUKALB ka kënaqësinë t'ju njoftojë se **Forumi i ardhshëm i Ujit të Danubit 2022 me temë “Energjizimi i Sektorit të Ujit në Rajonin e Danubit”** do të mbahet në datat **28-29 qershor 2022**, tek Rogner Hotel, Tiranë. Forumi do të pasohet nga **Konferenca me temë “Lidhja e Benchmarking dhe Menaxhimit të Aseteve – Mjetet kryesore për rregullatorët dhe vendimmarrësit”**, që do të zhvillohet më **30 qershor**.

Forumi organizohet nga Programi i Ujit të Danubit, i drejtuar nga IAWD dhe Banka Botërore, i bashkëfinancuar nga Qeveria Austriake, në bashkëpunim me SHUKALB. [lexo më shumë](#)

Çfarë ka të re në SHUKALB!

SHUKALB organizon takimin e parë të projektit “Hartimi i një dokument projekti për zbatimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë për trajtimin e

Trajnimet dhe programet e ardhshme të zhvillimit të kapaciteteve

[Mbikqyrje](#)

25-26 Maj 2022, Tirana

[Tubacionet Kryesore dhe Rezervuarët e Ujit](#)

16 Qershor 2022, Tirana

[Sistemet e Vogla të Furnizimit me Ujë](#)

17 Qershor 2022, Tirana

[Mirëmbajtja e Pajisjeve – Motorrat, Pompat dhe Valvulat për Profesionistët e Ujit të Ndotur dhe të Pijshëm](#)
22-23 June 2022, Tirana

Konferencat e Ardhshme Ndërkombëtare

[IFAT 2022 - Panairi tregtar kryesor në botë për ujë, kanalizime, menaxhimin e](#)

ujërave të ndotura në dy zona rurale në basenin e lumit Drin”



SHUKALB, në bashkëpunim me kompaninë italiane IRIDRA dhe Universitetin e Shkencave të Natyrës BOKU në Vjenë, Austri, organizuan më 21 Prill, në Hotel Rogner në Tiranë, takimin e parë për projektin “Hartimi i një dokument projekti për zbatimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë për trajtimin e ujërave të ndotura në dy zona rurale në basenin e lumit Drin”.

Projekti zbatohet në kuadër të Projektit “Promovimi i Menaxhimit të Qëndrueshëm të Burimeve Natyrore në Evropën Juglindore, nëpërmjet përdorimit të qasjes Nexus”, nga Global Water Partnership-Mediterranean (GWP-Med) në partneritet me Komisionin Ekonomik për Evropën të Kombeve të Bashkuara (UNECE), financuar nga Agjencia Austriake e Zhvillimit (ADA). [lexo më shumë](#)

Trajnime dhe programe të zhvillimit të kapaciteteve

Nxitoni të regjistroheni në kurset e ardhshme të trajnimit!



SHUKALB ju fton të merrni pjesë në kurset e ardhshme të trajnimit që organizohen përgjatë vitit 2022. Gjeni më shumë detaje në lidhje me regjistrimet për secilin trajnim, në Kalendarin më poshtë.

TRAJNIMET NË MAJ

[mbetjeve dhe lëndëve të para](#)

Mynih, Gjermani
30 Maj – 3 Qershor 2022

[Konferenca e 12-të e Micropol dhe Rrezikun Ekologjik](#)

Santiago de Compostela, Spanjë
6 - 10 Qershor 2022

[Humbjet e ujit 2022](#)

Pragë, Republika Çeke
19-22 Qershor, 2022

Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se cfarë mendoni!



MBIKQYRJE

25-26 May 2022, Tirana

Ky kurs trajnimi thekson rolin e mbikëqyrësit në përmbushjen e misionit dhe objektivave të shoqërive ujësjellës kanalizime. Kursi fokusohet tek aftësitë dhe njohuritë që duhet të ketë një mbikëqyrës mbi planifikimin, koordinimin dhe motivimin e punonjësve me qëllim që çdokush të punojë me efektivitet për përmbushjen e objektivave. Qëllimi kryesor i këtij kursi është që t'i pajisë pjesëmarrësit me njohuri dhe teknika të vlefshme mbikëqyrje për të përmirësuar performancën e shoqërive ujësjellës kanalizime.



Ky kurs trajnimi është veçanërisht i vlefshëm për drejtuesit dhe përgjegjësit e departamentit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun. [lexo më shumë](#)

Trajnimi “Shërbimi i Klientit dhe Marrëdhëniet me Publikun” u zhvillua me sukses



Në datat 27-28 Prill 2019, në Tiranë, SHUKALB zhvilloi me sukses kursin e trajnimit “Shërbimi i Klientit dhe Marrëdhëniet me Publikun” me pjesëmarrjen e përgjegjësve dhe specialistëve të departamenteve të Shërbimit të Klientit të Shoqërive Ujësjellës Kanalizime Korçë, Lezhë dhe Durrës. Trajnimi u mbajt nga Arian Gjorga, Ekspert në fushën e Menaxhimit dhe Shërbimit ndaj Klientit.


Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

Pjesëmarrësit morën njohuri të mjaftueshme mbi temat kyçe si, themelet e shërbimit të shkëlqyer, organizimi dhe personeli i shërbimit të klientit, informacioni dhe komunikimi me publikun/ menaxhimi i përshtypjeve të klientit, kënaqshmeria e klientit, menaxhimi i bazës së të dhënave, menaxhimi i ankesave të klientit, menaxhimi i leximit të matësive, menaxhimi i faturimit dhe arkëtimit, menaxhimi i ndërprerjes së shërbimit dhe shkëputjes nga rrjeti i furnizimit, udhëzimet baze për një plan të mirë komunikimi, dhe integrimi i tipeve të ndryshme të mediave në një program efikas komunikimi. [lexo më shumë](#)

Të tjera

SHUKALB ndan përvojën e tij në Takimin Rajonal të RCDN-së: Si të Krijoni dhe Menaxhoni një Qendër Trajnimi me ndikim?



Projekti Rrjeti Rajonal i Zhvillimit të Kapaciteteve (RCDN) organizoi më 1 prill 2022 takimin virtual të Rrjetit Rajonal: Si të krijoni dhe menaxhoni një qendër trajnimi me ndikim? Objektivat e takimit ishin shkëmbimi i praktikave të mira për krijimin e një qendre trajnimi dhe shkëmbimi i përvojave mbi faktorët kyç të suksesit në menaxhimin e një qendre trajnimi me ndikim.

Në takim morën pjesë përfaqësues të Shoqatave partnere të RCDN-së të Qeverisjes Vendore dhe të shërbimeve Ujësjellës Kanalizime, të cilët u njohën me disa prezantime në lidhje me praktikatat dhe përvojat më të mira në ngritjen dhe menaxhimin e një qendre trajnimi nga shoqatat partnere.

SHUKALB u përfaqësua në takim nga Jonida Ahmeti, Menaxhere e Trajnimeve dhe Zhvillimit Profesional. Znj. Ahmeti ndau faktorët kyç të suksesit të SHUKALB në menaxhimin e një qendre trajnimi me ndikim dhe përvojën në zhvillimin dhe ofrimin e trajnimeve dhe programeve për ngritjen e kapaciteteve.

Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, **Web:** www.shukalb.al

Çregjistrohu